

MA Enkelejda SEJDINI (BALLA)

Arkivi Shtetëror Vendor Elbasan

VEPRIMTARIA ARKIVORE NË PREFEKTURËN E ELBASANIT 1912 - 2017. SFIDA DHE ARRITJE

ABSTRAKT: *Punimi që po paraqes përbën një trajtesë shkencore dhe historike të punës me dokumentet në Prefekturën Elbasan. Shërbimi arkivor në vendin tonë si edhe ai në Prefekturën e Elbasanit ka rrugëtuar nëpër tërë etapat e lindjes, formimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar.*

Veprimtaria arkivore në këtë njësi administrative të qeverisjes vendore ka kaluar nëpër disa etapa zhvillimi dhe rritjeje. Duke filluar nga sekretaritë, e zyrat e korrespondencës (1912 - 1944) e deri tek zyrat arkivore pranë institucioneve shtetërore (1945-1990), po ashtu edhe ngritja dhe funksionimi i Arkivave Shtetërore Vendorë në qytetet Elbasan, Librazhd dhe Gramsh si qendra të grumbullimit, ruajtjes, përpunimit dhe shërbimit të fondeve arkivore (1990 - 2017).

Në vitin 2001 do të krijohet Arkivi Shtetëror Vendor Rajonal i Prefekturës Elbasan, si qendër e koordinimit dhe e drejtimit për gjithë punën arkivore në prefekturë. Arkivi Shtetëror Vendor aktualisht ka realizuar njërin nga drejtimet e veprimtarisë së tij, duke tërhequr dhe sjellë pranë qendrës të gjitha dokumentet e fondkrijuesve (1945 - 1990), duke krijuar kushte optimale për ruajtjen, përpunimin shkencor dhe njëherësh për shërbim të fondeve arkivore në kuadër të motivit “Shoqëri e lirë, Arkiva të hapura”. Aktualisht veprimtarinë e Arkivit Shtetëror Vendor Elbasan e presin sfida të reja konform arritjeve teknologjike në këtë fushë.

Hyrje

Prefektura e Elbasanit, një këndvështrim historik i organizimit administrativ

Si rezultat i zhvillimeve të brendshme ekonomiko – shoqërore, Elbasani dalëngadalë u shndërrua në një qendër të rëndësishme të zhvillimit ekonomik,

tregtar, social, shoqëror dhe arsimor. Gjatë sundimit Osman Elbasani ishte pjesë e vilajetit të Manastirit. Sanxhaku i Elbasanit kishte nën drejtim tri kaza: Elbasanin, Peqinin dhe Gramshin.¹

Pas shpalljes së Pavarësisë dhe formimit të shtetit të pavarur shqiptar më 28.11.1912, një ndër detyrat parësore, ishte shtrirja e sovranitetit në tërë territoret e banuara nga shqiptarët si dhe organizimi administrativ-territorial i vendit. Parimi bazë mbi të cilën do të mbështetej organizimi shtetëror ishte ai i “centralizimit” të pushtetit në linjë vertikale, mbështetur në “*Kanunin e Përshtatshëm të Administratës Civile të Shqipërisë*”. Sipas këtij Kanuni, vendi ndahej në prefektura, nënprefektura dhe krahina.² Një ndër prefekturat që do të krijoheshin ishte dhe ajo e Elbasanit, si një ndër njësitë administrative më të mëdha dhe më të rëndësishme të shtetit shqiptar. Në vendimet e 29 korrikut 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër vendosi që Shqipëria të ndërtohej si një shtet europian dhe jashtë varësisë e ndikimit të Perandorisë, duke i caktuar në krye një princ protestant, Vilhelm Vidin. Regjimi mbretëror u sanksionua nga “Statusi Organik i Shtetit Shqiptar” mbi të cilin do të organizoheshin territoret shqiptare. Ky statut u miratua më 10.04.1914 nga KNK dhe vlerësohet në historinë e shtetit dhe të së drejtës si ligji i parë themeltar (kushtetuta) i organizimit të shtetit shqiptar.³

Nga ana administrative, Shqipëria ndahej në 7 sanxhaqe (prefektura) të cilat ndaheshin në kaza (nënprefektura) dhe nahije (komuna).⁴ Një ndër prefekturat ishte edhe ajo e Elbasanit.

Pas Luftës së Parë Botërore dhe zgjidhjes së problemit kombëtar, Kongresi i Lushnjës (20-31 janar 1920) miratoi “Bazat kanunore të Këshillit të Lartë”. Statuti i Lushnjës do të ligjëronte organizimin e mëparshëm administrativ deri në vitin 1924, me të vetmin ndryshim rritjen e numrit të prefekturave nga 7 në 9 prefektura. Për herë të parë nëpërmjet Ligjit Organik mbi organizimin e Bashkive, hyri si emërtesë e re e qeverisjes vendore “Bashkia”. Sipas këtij ligji, “Bashki” mund të shpallej vetëm një qytet që kishte mbi 250 familje.⁵

Me shpalljen e Republikës Shqiptare më 21 janar 1925 u bë riorganizimi i ri administrativ-territorial i vendit. Sipas ligjit për administratën civile territori i Shqipërisë ndahej në 10 prefektura, çdo prefekturë kishte dy a më shumë nënprefektura, të cilat përfshinin disa krahina (komuna).⁶ Sipas riorganizimit që u zhvillua më 1926 vendi ndahej në katër departamente dhe Prefektura e Elbasanit bënte pjesë në departamentin Qendror, e cila riorganizohej në njësi më të vogla administrative dhe kishte në përbërje të saj 2 nënprefektura, Gramshin dhe Peqinin.⁷

Pas shpalljes së Monarkisë dhe miratimit të Statutit të saj mund të themi që

nuk u bënë ndryshime. Edhe më 1929, prefektura e Elbasanit vazhdonte të ndahej në 2 nënprefektura.⁸

Sipas Ligjit të vitit 1938 mbi ndarjen e administrative të vendit “Mbi krijimin e disa nënprefekturave, suprimimin e disa bashkive, krijimin e disa komunave si dhe ndryshimin e disa juridiksioneve të reja”, Prefektura e Elbasanit përsëri kishte 2 nënprefektura, nënprefekturën e Gramshit dhe nënprefekturën e Peqinit me 18 komuna dhe rreth 308 fshatra⁹. Ky organizim administrativ – tokësor u ruajt deri në pushtimin fashist të vendit, i cili në vitin 1940 bëri ndarjen e re administrative duke ruajtur 10 njësitë e mëdha “Prefektura”. Prefektura e Elbasanit kishte në varësi 2 nënprefektura Peqinin dhe Gramshin, Bashkinë Elbasan si dhe 15 komuna e 315 fshatra¹⁰.

Pas Luftës së Dytë Botërore, me çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe të ardhjes në pushtet të qeverisë demokratike (e majtë) më 22.08.1946 shpalli Ligjin nr. 284 “Mbi ndarjen e re administrative tokësore të Republikës Popullore të Shqipërisë”. Sipas këtij ligji Prefektura e Elbasanit me qendër në Elbasan përbëhej nga: nënprefektura e Elbasanit, nënprefektura e Peqinit, nënprefektura e Gramshit dhe nënprefektura e Librazhdit.¹¹ Dekreti i vitit 1953 “Për ndarjen administrative – tokësore” ndryshoi tërësisht emërtesën e njësive administrative në tërë Republikën e Shqipërisë, njëkohësisht dhe në Prefekturën Elbasan. Në këtë dekret futen emërtesa si qarku, rrethi, qyteti, lokaliteti dhe fshati. Qarku i Elbasanit përbëhej nga 4 rrethe: Rrethi i Elbasanit,¹² Rrethi i Gramshit, Rrethi i Librazhdit dhe Rrethi i Peqinit. Në vitin 1958 me dekretin e ri qeveritar nr. 2773 u kalua në ndarjen e re administrative, ku suprimohet njësia qark dhe si njësi e madhe vendore caktohet rrethi. Vendi u nda në 26 rrethe dhe njëri nga rrethet e mëdha në qendër të Shqipërisë ishte edhe *rrethi i Elbasanit* që përbëhej nga 12 lokalitete.¹³ Kjo ndarje administrative e sipërshtënuar qëndroi deri në vitin 1967, kur me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor “Mbi zgjedhjet e Këshillave Popullore dhe Gjykatave Popullore” futet një element i ri në organizimin administrativ me termin “Këshilli i Fshatit të Bashkuar”, i dalë prej procesit të kooperimit socialist të bujqësisë. Sipas kësaj ndarjeje Shqipëria ndahet në 26 rrethe dhe konkretisht, Rrethi i Elbasanit përbëhej: 1. Qyteti i Elbasanit me 13 lagje, 2. Qyteti i Cërrikut me 13 lagje, 3. Qyteti i Peqinit, 4. Lokaliteti i Qendrës, 5. Lokaliteti i Krrabës, 6. Lokaliteti i Labinotit, 7. Lokaliteti i Shpatit, 8. Lokaliteti i Zaranikës.¹⁴ Rrethi i Gramshit përbëhej: 1. Qyteti i Gramshit, 2. Lokaliteti i Kërpicës, 3. Lokaliteti i Poroçanit, 4. Lokaliteti i Sojnikut, 5. Lokaliteti i Tunjës¹⁵. Rrethi i Librazhdit përbëhej :1. Qyteti i Librazhdit, 2. Lokaliteti i Çermenikës, 3. Lokaliteti i Hotolishtit, 4. Lokaliteti i Lunikut, 5.

Lokaliteti i Polisit, 6. Lokaliteti i Prrenjasit, 7. Lokaliteti i Qykësit¹⁶.

Sipas pasqyrës përmbledhëse mbi numrin e qyteteve, lagjeve, lokaliteteve, fshatrave të bashkuar dhe fshatrave deri më datë 4 maj 1970, rrethi i Elbasanit kishte: 3 qytete, 16 lagje, 4 lokalitete, 27 fshatra të bashkuar dhe 176 fshatra. Rrethi i Gramshit kishte: 1 qytet, 3 lokalitete, 10 fshatra të bashkuar, 72 fshatra dhe rrethi i Librazhdit kishte: 2 qytete, 5 lokalitete, 4 fshatra të bashkuar, 57 fshatra.¹⁷

Dokumentacioni i këtyre njësive administrative të krijuara pas vitit 1944 ruhet, administrohet dhe shërbehet në Arkivin Shtetëror Vendor të Elbasanit. Ndryshimet politike të ndodhura në Shqipëri pas viteve 1990 u shoqëruan edhe me ndryshime në organizimin administrativ – territorial. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 269 datë 25.06.1992 u kalua në ndarjen e re administrative, e cila kishte një piramidë të tillë: rreth, bashki, komunë. Me ligjin nr. 7608 datë 22.09.1992 u rivendos si njësi më e madhe administrative “Prefektura”. Në shkallë republike u krijuan 12 Prefektura, një nga këto ishte edhe ajo e Elbasanit. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 269 datë 25.06.1992 prefektura e Elbasanit ndahej në 4 katër rrethe: Rrethi i Elbasanit, rrethi i Librazhdit, rrethi i Gramshit dhe rrethi i Peqinit.¹⁸

Me aprovimin e Kushtetutës së vitit 1998 u bë përsëri riorganizimi administrativ – territorial ku suprimohen rrethet dhe krijohen qarqet. Një ndër këto ishte dhe qariku i Elbasanit, i cili vazhdon të funksionojë. Ligji nr. 8653 datë 31.07.2000 “Për ndarjen administrative – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” çoi në krijimin e 12 qarqeve. *Qariku Elbasan përbëhej* :1. Bashkia Elbasan, 2. Bashkia Cërrik, 3. Bashkia Belësh, 4. Komuna Gostimë, 5. Komuna Labinot – Fushë, 6. Komuna labinot – Mal, 7. Komuna Fierzë, 8. Komuna Gjinar, 9. Komuna Mollas, 10. Komuna Shushicë, 11. Komuna Shalës, 12. Komuna Gjergjan, 13. Komuna Kajan, 14. Komuna Grekan, 15. Komuna Funar, 16. Komuna Rrasë, 17. Komuna Shirgjan, 18. Komuna Tregan, 19. Komuna Gracen, 20. Komuna Bradashesh, 21. Komuna Zavalinë, 22. Komuna Papër, 23. Komuna Klos.¹⁹ U krijuan gjithsej 50 njësi të qeverisjes vendore. Ky organizim do të qëndroi në fuqi deri në vitin 2014, pasi me Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo – territoriale të Njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” aktualisht ky territor do të ndahej në 12 qarqe dhe 61 bashki. Aktualisht Qariku i Elbasanit ka 7 Bashki, Bashkinë Elbasan, Bashkinë Cërrik, Bashkinë Belsh, Bashkinë Peqin, Bashkinë Gramsh, Bashkinë Librazhd, Bashkinë Prrenjas dhe 46 njësi administrative.²⁰

1. Pasuria arkivore në Prefekturën Elbasan

a. Arkivat në vitin 1912-1944

Koncepti i arkivave, si traditë kombëtare dhe kulturore, ka marrë vëmendjen e duhur dhe përkujdesjen e madhe vetëm pas çlirimit të vendit. Arkiva filloi të vlerësohej si “kujtesa e tij” kolektive që mishëron përvojën e grumbulluar të qytetarëve të tij. Lidhja midis konceptit kulturor, të shkencave arkivore si mjet administrativ dhe i shkencës arkivore si një mjet për kërkime historike, shpjegon sot ambiguitetin në të kuptuarit e natyrës së vërtetë të arkivave dhe vlerës që kanë për kombin.²¹

Veprimtaria arkivore dhe puna me dokumente për herë të parë në historinë e Shqipërisë mori karakter institucional më 22 nëntor 1913, kur Qeveria e Përkohshme e Vlorës hartoi Kanunin e Administratës Civile të Shqipërisë. Sipas këtij Kanuni, pranë prefekturave, nënprefekturave, krahinave, etj., do të funksiononte edhe një zyrë për administrimin e dokumenteve. Madje në prefektura do të kishte, përveç një sekretari dhe një kryesekretari, për cilin si detyrë e parë përcaktohej “...qeverimi i punëve që i përkasin letërkëmbimeve të prefekturës, rregullimi i opsitaave, si dhe ruajtja e tyre. Për të kryer këto detyra do të ketë pranë tij një zyrë të letërkëmbimit dhe një drejtor të shkresave”.²² Me këto përcaktime për herë të parë materializohet në një akt të tillë të rëndësishëm vlerësimi i dokumenteve dhe administrimi i tyre nga struktura të veçanta shtetërore. Prefektura Elbasan, si njësi e madhe administrative, në përbërje të së cilës ka pasur disa nënprefektura dhe komuna, kanë pasur barrën e madhe të organizimit dhe drejtimit të veprimtarive ekonomike, politike e shoqërore. Në këtë proces organizimi dhe drejtimi të cilat janë dhe sektoriale, ishin krijuar një mori e madhe aktesh e dokumentesh, të cilat janë ruajtur në sekretaritë e institucioneve, punonjësit e të cilëve quheshin sekretar, shkrues, apo kopistë.

Sipas Ligjit Organik të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 14 korrik 1928, pranë administratës qendrore të kësaj ministrie, krahas drejtorive e zyrave të tjera, do të formohej edhe një *Drejtori korrespondence*, në përbërje të së cilës do të ishte drejtori, sekretari i parë, sekretari i dytë, protokollisti, arshivisti, dy opsita dhe një praktikant.²³

Jo vetëm në Prefekturën e Elbasanit por edhe në shkallë kombëtare nuk ka pasur institucion të veçantë arkivor për ruajtje e përpunim dokumentesh. Me krijimin e Arkivit Qendror të Shtetit më 08.06.1949 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit më 29.04.1955, situata arkivore kombëtare ndryshon tërësisht. Arkivat “si tërësia e dokumenteve të marra zyrtarisht, ose të krijuara nga një organ

administrativ ose nga një zyrtar i saj, apo si grumbullim i rregullt i dokumenteve, të cilat krijohen gjatë veprimtarisë së një instituti, apo individit, të cilat janë ruajtur për arritjen e qëllimeve të tij politike, ligjore dhe kulturore nga ky institut ose individ”,²⁴ shndërrohen në institucione të ngritura mbi baza ligjore në shkallë kombëtare.

Fondi arkivor i Prefekturës Elbasan, deri në vitin 1944 që ruhen në AQSH përmban lloje të ndryshme dokumentesh si:

- 1 - Dokumente të administratës së kohës
- 2 - Dokumente të pronësisë
- 3 - Dokumente teknike
- 4 - Dokumente të personaliteteve të shquara në sferat e ndryshme
- 5 - Dokumente të administratës së huaj të pushtuesve (Lufta e Parë Botërore dhe Lufta e Dytë Botërore)

Nga viti 1912 – 1944, në Arkivin Qendror të Shtetit ruhen me shumë përkujdesje pasuri e konsiderueshme arkivore me origjinë nga Prefektura Elbasan, gjithsej 25 fonde me 30 ml dokumente.

b. Fondi Arkivor i Prefekturës Elbasan 1945 – 1990

Pas çlirimit, pushteti komunist shembi një sistem politik dhe mbi bazën e tij u ngrit pushteti i ri. Ndryshoi tërësisht organizimi administrativ dhe emërtesa institucionale. Ajo që kishte mbetur ishte fakti interesant, pasi institucionet shtetërore, objektivisht janë prodhues të akteve zyrtare, si mjete programore teknike dhe komunikimi. Rrjedhimisht pranë çdo institucioni i klasifikuar “fondkrijues”, me ligj dhe rregullore u krijuan sekretari – arkivat, apo arkivat institucionale dhe njëherësh u krijua ngadalë një shtresë e re nëpunësish, punonjësish të sekretarisë, protokollit, dhe arkivave.

- **Në rrethin Elbasan** funksiononin 57 fondkrijues që i përkisnin organeve të qeverisjes vendore, prej të cilëve: Komiteti i Partisë së Rrethit Elbasan, Komiteti Ekzekutiv i K. P. rrethit Elbasan, Organizatat e Masave: Fronti Demokratik i Rrethit, Komiteti i Rinisë së Rrethit, Organizata e Bashkimit të Grave të Rrethit, dhe Organizata e Bashkimit Profesional të Rrethit (4 fondkrijues gjithsej). Këshilla Popullore të Qyteteve, përkatësisht i Elbasanit, Cërrikut dhe i Peqinit (4 fondkrijues), Këshilla Popullore të lagjeve të qytetit Elbasan, (16 fondkrijues), Këshillat Popullore të Lokaliteteve të Krrabës, Labinotit, Shpatit dhe Zaranikës gjithsej (4 fondkrijues), Këshillat Popullore të Fshatrave të Bashkuara, gjithsej (27 fondkrijues).²⁵
- **Në rrethin Librazhd** funksiononin 17 fondkrijues të organeve të

qeverisjes vendore si: Komiteti i Partisë së Rrethit Librazhd, Komiteti Ekzekutiv i K. P. Rrethit Librazhd, Organizatat e masave (4 fondkrijues), Këshillat Popullorë të Qyteteve Librazhd dhe Prrenjas (2 fondkrijues), Këshillat Popullorë të Lokaliteteve (5 fondkrijues), Këshillat Popullorë të Fshatrave të Bashkuar (4 fondkrijues).²⁶

- **Në rrethin Gramsh** funksiononin 20 fondkrijues të institucioneve të qeverisjes vendore si: Komiteti i Partisë së Rrethit Gramsh, Komiteti Ekzekutiv të K/P Rrethit Gramsh, Organizatat Masave (4 fondkrijues), Këshilli Popullor i Qytetit Gramsh (1 fondkrijues), 3 fondkrijues përbënin Këshillat Popullorë të Lokaliteteve, 10 fondkrijues Këshillat Popullorë të Fshatrave të Bashkuar.²⁷

Njëherësh pranë çdo fondkrijuesi funksiononte sekretari–arkivi, si pjesë përbërëse e strukturës institucionale, me detyrë ligjore përpunimin, ruajtjen, shërbimin e tërë akteve ligjore të krijuara nga vetë institucioni.

c. Fondi arkivor i Prefekturës Elbasan pas viteve 1990

Fundi i shekullit XX-të (vitet 1990-të) për Shqipërinë dhe shqiptarët, përbën dekadën e fillimit të ndryshimeve të mëdha politike dhe shoqërore dhe futjen e shoqërisë në rrugën e proceseve demokratike. Në këtë proces, i cili “*nuk ishte ndryshim kostum?*” për shoqërinë, e cila në dekadat e para u gjend në një fazë të çuditshme “tranzicioni”. Nuk mund të mbetej jashtë, këtyre proceseve puna me dokumentet dhe institucionet arkivore të cilat rrjedhimisht futen në rrugën e transformimeve demokratike. Problemi ishte evident, i prekshëm dhe real. Institucionet e shtetit me jetëgjatësi afro 40 vjeçare, pushuan së ekzistuari veprimtarinë. Çdo të bëhej dhe si do të trajtohej e tërë prodhimtaria dokumentare e krijuar nga këto institucione?!

Qeveria e Parë Demokratike, duke e vlerësuar realisht situatën me vendim të posaçëm, shpalli “tërë pasurinë dokumentare të institucioneve që pushojnë veprimtarinë, si Komitetet e Partisë, Organizatat e Masave, Komitetet Ekzekutive, Këshillat e Bashkuar, ndërmarrjet ekonomike, shkollat etj., pasuri të shtetit dhe merrte në mbrojtje dhe ruajtje ato”.

Mbi bazën e këtij realiteti lindi domosdoshmërisht nevoja e ngritjes së arkivave rajonale mbi bazë Rrethi, të cilët do të merrnin nën mbrojtje, ruajtje, administrim, përpunim, shfrytëzim të tërë pasurinë dokumentare të krijuara nga veprimtaria e institucioneve shtetërore të shembura.

Në Prefekturën e Elbasanit Arkivi Shtetëror i Rrethit Elbasan e filloi veprimtarinë e tij në mars të vitit 1990, drejtor i parë së cilit ishte Z. Hysen

Shabanaj.²⁸ Me propozim të DPA dhe të Këshillit të Rrethit Librazhd më date 24.09.1994 u ngrit Arkivi Shtetëror në rrethin e Librazhdit dhe më 01.10.1994 emërohet specialist arkivi Z.Shaban Gjura.²⁹ Më shkurt të vitit 1994 ngrihet dhe Arkivi Shtetëror i Rrethit Gramsh me specialist arkivi Z.Nazmi Dragoti.³⁰ Si godinë për grumbullimin e dokumenteve dhe nga ku do të kryente veprimtarinë e vet ky arkiv, shërbeu godina e Objektivit Arkivor Nr. 3, objekt në të cilin ruheshin më pare një pjesë e mirë e dokumentacionit të Arkivit të Shtetit.³¹

Në zbatim të vendimit të qeverisë, dhe udhëzimeve të D.P.A-së detyra thelbësore e këtyre institucioneve ishte “evidentimi”, marrja në mbrojtje dhe më pas nën ruajtje e dokumenteve të cilat kishin pushuar veprimtarinë. Ky proces përbën fillimet e veprimtarisë së Arkivit Shtetëror Vendor, në rrethet Elbasan, Gramsh, Librazhd, veprimtari e cila duhet vlerësuar pozitivisht, pasi punonjësit megjithëse të pakët në numër, falë punës me përkushtim dhe pasion, megjithëse kushteve të vështira, kanë mundur që “evazioni dokumentar” (dëmtimi fondevë, mos ruajtja, nxjerrja dhe hedhja jashtë, pasi në disa raste pronarët kërkonin lirin e ambienteve), ka qenë i pakët. Fillimet e veprimtarisë së ASHV-së ngadalë, por mundën që situatën arkivore, ta venë nën kontroll dhe njëherazi të organizojnë punën me theks, drejtues, trajnues me punonjësit, që kishin dhe punonin me dokumentet, duke i dhënë përparësi punës për dorëzimin e dokumenteve të trashëguara në Arkivat Shtetërore Vendorë të rretheve.

Më 27 korrik të 1992, fillojnë veprimtarinë organet e qeverisjes vendore, Bashkitë dhe Komunat, të cilat trashëguan asetet arkivore të “Komiteteve të Partisë”, të “Komiteteve Ekzekutive” dhe Komunat, asetet arkivore e “Këshillave të Bashkuara” dhe të Kooperativave Bujqësore. U ngritën struktura shtetërore të posaçme si “Stafet likuiduese”, me objekt krahas të tjerash, administronin edhe dokumentet institucionale. Gjatë fillësive të veprimtarisë së këtyre institucioneve është vërejtur, neglizhencë, mospërkudësje, apo ruajtje të këtyre dokumenteve të krijuar nga “sistemi i shkuar”, fenomene këto që çonin në “evazion dokumentar”.

Deri në vitin 2001, kur Arkivat Shtetërore Vendorë të rretheve shkrihen dhe krijohet Arkivi Shtetëror Vendor në shkallë qarku, ato kishin tërhequr, ruanin, përpunonin dhe shërbenin një numër të madh fondesh dhe sasi të madhe dokumentesh, dhe në këtë vit, pothuajse në shkallë prefektore kishte përfunduar tërheqja e tërë fondevë arkivore të mbyllura.

Sipas evidencës të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe kooperativave bujqësore që e kishin mbyllur veprimtarinë e tyre fondkrijuese rezultoi se:

- Në ASHV Elbasan ishin regjistruar 89 fondkrijues, kurse fonde arkivore të hyra në arkiv ishin 53.³²
- Në ASHV Librazhd ishin regjistruar 69 fondkrijues, kurse fonde arkivore të hyra në arkiv ishin 69.³³
- Në Arkivin Shtetëror Vendor Gramsh ishin regjistruar 36 fondkrijues, fonde arkivore të hyra në arkiv 41.³⁴

Jo pa qëllim i renditëm në këtë mënyrë numrin e fondkrijuesve dhe fondet e hyra në arkiv, pasi ne qartësohem për fondet e munguara në ASHV Elbasan, dhe njëherazi, shpesh shtrohet detyra e gjurmimit të fondeve arkivore të munguara.

Pas vitit 1992 pranë Arkivave Shtetërorë Vendorë të rretheve regjistrohen fondkrijues të rinj, si komunat dhe bashkitë:

Në Librazhd: Bashki 2, komuna 9;

Në Elbasan: Bashki 2, komuna 21;

Në Gramsh: Bashki 1, komuna 9.

Këto fondkrijues, me Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003, “Për Arkivat” neni 43 pika a, detyrohen çdo 10 vjet të dorëzojnë në ASHV Elbasan dokumentet e vitit fillesë të sistemuara dhe të inventarizuara.

3. Kushtet e ruajtjes, shkalla e përpunimit tekniko – shkencor e fondeve arkivore dhe shërbimi arkivor

Celuloza, që është përbërësi kryesor i letrës së dokumenteve, është shumë e ndjeshme ndaj veprimit të faktorëve fizikë, kimikë e mikrobiologjikë, të cilët shkaktojnë ndryshime të tilla strukturore, duke sjellë dhe dëmtim apo asgjësim të plotë të dokumenteve.³⁵ Kjo është arsyeja përse ruajtjes së dokumenteve i kushtohet vëmendje e madhe dhe e vazhdueshme, në mënyrë që jeta e dokumenteve të jetë sa më e gjatë.

Pas viteve 1990-të, D.P.A. e ndjeshme ndaj situatave ekzistenciale arkivore, mori si përgjegjësi dhe ndërtoi në Prefekturën e Elbasanit një godinë të mirëfilltë arkivore, me të gjitha parametrat e duhura dhe funksionale për ruajtjen, përpunimin dhe shërbimin e fondeve arkivore. Vendimi për miratimin e sheshit të ndërtimit të godinës së Arkivit Shtetëror Vendor të Rrethit Elbasan u mor në vitin 1988. Ishte pikërisht vendimi nr. 92 datë 24.05.1988 i Komitetit Ekzekutiv i K. P. Rrethit Elbasan që vendosi përfundimisht miratimin e këtij sheshi sipas të cilit arkivi i rrethit Elbasan do të ndërtohej ngjitur me Komitetin Ekzekutiv, në faqen jugore të tij me një sipërfaqe prej 0.15. ha.³⁶

Kjo godinë ka një sipërfaqe objekti prej 305,50 m² + sipërfaqe trotuari 78.30 m², e tëra 383.80 m². Katër katet mbi dhe të godinës kanë një sipërfaqe të përgjithshme 1535,2 m² dhe një vëllimi i saj 3,838 m³. Sot në këtë godinë ruhen 300 fonde arkivore me një sasi të përgjithshme prej 1,600 ml dokumente. Godina e ASHV është ndërtuar në qendër të qytetit, e orientuar mirë (drejtim veri-jug) dhe është ideuar si godinë me 5 kate, një kat të nëndheshëm dhe katër kate mbi sipërfaqe të tokës. Kjo godinë e ndërtuar për ruajtje dokumentesh, eliminon një sërë rreziqesh, si përmbytjet, dhe është e ndërtuar në vend të qëndrueshëm, larg zonave industriale, që prodhojnë ndotje dhe larg objekteve që prodhojnë zhurmë.

Stafi i ASHV Elbasan nga viti 1994 ka bërë kujdes të veçantë që të njohë, të eliminojë maksimalisht faktorët dëmtes të dokumentacionit, pasi mosvlerësimi i tyre objektivisht çon drejt dëmtimit të fondeve arkivore deri në asgjësim të plotë të dokumenteve.

Fondi arkivor i Prefekturës së Elbasanit, i cili fillon në vitin 1913 si pjesë përbërëse e Fondit Arkivor Kombëtar dhe pjesë e trashëgimisë sonë kombëtare, pas vitit 1944 ruhet, përpunohet dhe shërbehet në Arkivin Shtetëror Vendor Elbasan. Në të ruhet i tërë dokumentacioni i organeve shtetërore vendore të Prefekturës së Elbasanit, të nënprefekturës Librazhd dhe Gramsh dhe pas vitit 1992 i organeve shtetërore vendore, bashki dhe komuna.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 199, dt. 20.05.1992 fondet arkivore të Partisë së Punës së Shqipërisë, të Bashkimit të Grave të Shqipërisë, të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë dhe të Frontit Demokratik të Shqipërisë kaluan në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, duke u konsideruar fondkrijues me veprimtari të mbyllur.³⁷ Pra e tërë pasuria arkivore nga viti 1944-1990 shpallet pronë e shtetit dhe pasuri arkivore kombëtare, njëherazi dhe pjesë e trashëgimisë kulturore.

Rezultat i këtij vendimi si dhe miratimi i Ligjit nr. 7726 datë 29.06.1993 “Për fondin arkivor dhe arkivat”, ishte krijimi i hapësirës së duhur ndër-institucionale dhe funksionimi i Arkivave Shtetërore Vendore të rretheve, Librazhd dhe Gramsh, si nënjesi të Prefekturës Elbasan, të cilat tërhoqën për ruajtje, përpunim dhe administrim të fondeve arkivore të institucioneve që pushuan veprimtarinë e tyre .

Për shkak të ndryshimeve të vrullshme politike, në shumë raste tërheqja e fondeve arkivore që gjendeshin pranë institucioneve të shuara kryhej në kushtet e emergjencës me qëllimin e vetëm vendosjen nën ruajtje dhe mbrojtje për t'i shpëtuar nga rreziku i asgjësimit. Praktika të tilla, anashkalonin tërë aktet

rregullatore dhe ligjshmërinë e dorëzimit të dokumenteve në ASHV Elbasan, Librazhd dhe Gramsh.

Vetëm fondet arkivore të Komiteteve të Partisë së Rretheve, Komiteteve Ekzekutive të rretheve, dhe të Organizatave të masave që kanë hyrë në ASHV Elbasan, Gramsh, Librazhd janë sistemuar dhe të përpunuara deri në inventar, sipas tërë praktikave metodike e shkencore të miratuara nga D.P.A.

Në kushte të tilla, stafet arkivore në ASHV Elbasan punonin njëherësh në tre drejtime themelore:

- a - Tërheqja dhe vendosja në sallat e ruajtjes të fondeve arkivore;
- b - Përpunimi tekniko – shkencor sipas metodave të përpunimit tekniko – shkencor të fondeve të papërpunuara;
- c - Shërbimi arkivor në funksion të studiuesve, qytetarëve dhe institucioneve.

Këto procese pune arkivistët i realizonin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe duke respektuar Kodin deontologjik të arkivistëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Këshillit Kombëtar të Arkivave të mbajtur në Pekin më 6 shtator 1996, kod i cili shtronte para arkivistëve *“të ruajnë integritetin e arkivave duke garantuar kështu, atë që arkivat përbëjnë një dëshmi të së kaluarës së gjatë që meriton besim.”*³⁸

Pas një periudhe të shkurtër punë dhe fillimin e mbarë të aktivitetit arkivistik në Prefekturën Elbasan gjatë muajve mars, prill të vitit 1997, për shkak të acarimeve politike dhe për arkivat u krijua një situatë jo normale. Arkivi Shtetëror Vendor i rrethit Elbasan gjatë kësaj periudhe u bë pre e dhunës dhe e ndërhyrjes me forcë të disa personave të cilat dëmtuan dhe vodhën një sasi të konsiderueshme dyersh, dritaresh, ndriçuesish. Fatmirësisht dokumentacioni arkivor i regjistruar në këtë arkiv nuk u cenua.

Ndryshe ndodhi në Arkivin Shtetëror të Rrethit Gramsh ku situata dhe shpërthimet sociale dalin jashtë kontrollit dhe ASH i Rrethit Gramsh u bë pre e goditjeve dhe grabitjeve e fondeve arkivore, të cilat u përfshinë nga flakët. Rrjedhojë e këtyre zhvillimeve më 14.11.1997 drejtori i Arkivi Shtetëror Vendor i rrethit Gramsh informon se: *“ në objektin e Arkivit të Rrethit Gramsh, ku ndodheshin ndonëse në gjendje të shkatërruar e të dëmtuar dokumentacioni i të gjithë kooperativave bujqësore dhe i ndërmarrjeve të privatizuara të rrethit, ra zjarr i cili përfshiu të gjithë ambientin. Pas konstatimit të zjarrit u lajmërua komisariati i policisë dhe reparti zjarrfikës, të cilët morën masa për fikjen e zjarrit. Mbas fikjes së zjarrit, vatra të caktuara të të cilët shfaqeshin herë pas here për disa ditë rresht, mundën të hyjnë në thellësi të gjithë dokumenteve ndërsa dëmin më të madh e ka shkaktuar uji”*.³⁹ Dokumentacioni i shpëtuar nga zjarri u strehua përkohësisht në një shkollë të mesme në qytetin e Gramshit, ku u grumbulluan

mbi 200 ml dokumente, nga 600 ml dokumente që ishte sasia fillestare, gjendja e të cilave ishte shumë e keqe. Brenda këtyre kushteve jo të përshtatshme u arrit të përmirësohej disi gjendja e këtyre dokumenteve, por për mungesë ambienti të posaçëm për një arkiv, nuk u bë e mundur kryerja e procesit të sistemimit dhe risistemimit të tyre.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 683 datë 13.12.2001 “Për organizimin e rrjetit arkivor të vendit” solli sërish strukturë të re arkivore në prefekturë. Arkivi Shtetëror Vendor i Rrethit Gramsh pushoi së funksionuari si arkiv dhe kaloi degë arkivore e Arkivit Shtetëror Vendor të qarkut Elbasan. Kjo degë arkivore e vazhdoi veprimtarinë e saj deri në korrik të vitit 2004, pasi me urdhrin nr. 6 datë 12.07.2004 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave vendosi transferimin e fondeve arkivore të degës së arkivit Gramsh në Arkivin Shtetëror të Qarkut Elbasan.⁴⁰

Dhe Arkivi Shtetëror Vendor i Rrethit Librazhd, në qershor të vitit 2002 bëhet degë arkivore e Arkivit Shtetëror të Qarkut Elbasan dhe funksionoi si i tillë deri në shkurt të vitit 2007, kur u bë dhe dorëzimi përfundimtar i fondeve arkivore të kësaj dege pranë Arkivit Shtetëror Vendor Elbasan.⁴¹

Arkivi Shtetëror Vendor Elbasan si institucion i vetëm, pjesë përbërëse e rrjetit arkivor kombëtar, në kushtet e reja funksionale ndeshet me dukuri të reja arkivore. Një ndër këto drejtime të veprimtarisë arkivore është dhe pasurimi i ASHV Elbasan me fonde të reja, që burojnë nga regjistri i emërtesës së fondkrijuesve. Në vitet 2002-2003 njësitë e qeverisjes vendore, bashkitë, komunat duhen të dorëzonin në ASHV Elbasan dokumentacionin e vitit fillesë, të sistemuara, të përpunuara, të inventarizuara dhe me procesverbale dorëzimi. Ky detyrim buron nga ligji për arkivat.

ASHV Elbasan ka luajtur dhe luan rol të rëndësishëm në drejtim të shërbimit të dokumenteve duke plotësuar dhe përmbushur nevojat e shtetasve dhe studiuesve. Në këtë çerek shekulli veprimtarie të ASHV Elbasan për shkak të numrit të kufizuar të stafit dhe të nevojave urgjente të kategorive të ndryshme shoqërore, shërbimi arkivor shndërrohej në prioritet, duke e zbehur disi punën në drejtim të përpunimit tekniko – shkencor të fondeve të hyra në arkiv të papërpunuara.

Një veprimtarie e tillë shpesh merrte pjesën më të madhe të kohës së punës dhe në periudha të caktuara institucioni merrte më shumë karakter shërbimesh institucionale arkivore. Duke qenë para një realiteti të tillë, stafi arkivor ka bërë kujdes që kohën e planifikuar të punës ta parcelizojë në mënyrë racionalë që dhe drejtimet e tjera të veprimtarisë të mos mbeteshin pas.

Përfundime

Si përfundim shprehemi me bindje se Arkivi Shtetëror Vendor Elbasan u shndërrua në një qendër, institucion modern për grumbullimin dhe ruajtjen e tërë pasurisë arkivore në Prefekturën Elbasan.

Së dyti Arkivi Shtetëror Vendor Elbasan përbën sot bërthamën ku realizohet dhe zbatohet shkenca e arkivistikës në fushën e përpunimit tekniko – shkencor të dokumentacionit, të çdo fondkrijuesi, proces ky që nuk është “stoli” e vetë këtij institucioni, por ASHV Elbasan është shndërruar, në “ shkollë” ku mësohet shkenca për përpunimin teknik të dokumenteve.

Së treti Arkivi Shtetëror Vendor Elbasan, fill pas themelimit të tij, ka realizuar me sukses shërbimin arkivor dokumentar, si funksion i nevojave të shoqërisë, të individëve apo të institucioneve dhe studiuesve.

Në këtë aspekt të veprimtarisë së këtij institucioni, ka shkëlqyer puna e stafit arkivor, për etikë pune, përkushtim, zbatim të rregullave dhe normave ligjore, për integritet profesional, duke e bërë këtë institucion “emër mirë” në prefekturë.

ABSTRACT: The material I am presenting, consists of a serious scientific and historical treatment, of work with documents, in the Prefecture of Elbasan. The archival service in our contry as well as the one in Elbasan Prefecture has been running throughout the stages of birth, formation and consolidation of Albania state.

The archival activity in this administrative unit of local government has gone through several stages of development and growth. Starting from secretariats, correspondence offices (1912-1944) to archival offices at state institutions (1945-1990), as well as the establishment and functioning of the Local State Archives in the city of Elbasan, Librazhd and Gramsh as centers of collection, storage, elaboration and archive fundraising (1990-2017).

In 2001, the Regional State Archive of the Elbasan Prefecture will be established, as a coordination and management center, of all archival work in the prefecture. The local state archive has actually accomplished on of the directions of its activity by obtaining and bringing all fund-maker documents (1945-1990) to the center, creating optimal conditions for storage, scientific elaboration, and at the same time to serve the archival funds within the framework motion “Free Society, Open Archives”.

Currently the activity of the Elbasan Local State Archive is facing new challenges in line with the technological achievements in this field.

-
1. Bartl, Peter: *Myslimanët Shqiptarë në Lëvizjen për pavarësi Kombëtare (1878-1912)*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Dituria", 2006, fq. 82.
 2. *Histori e Popullit Shqiptar*, Vëll. III (Pavarësia e Shqipërisë 28 Nëntor 1912- 7 prill 1939), Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti I Historisë, Tiranë: Toena, 2007, fq. 120.
 3. *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëll. I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti I Historisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2017, fq. 298.
 4. Duka, Valentina: *Histori e Shqipërisë (1912 – 2000)*, Tiranë: SHBLU , 2007, fq. 62.
 5. Fletorja Zyrtare, Viti 1923, 07 kallnur, fq. 4.
 6. Duka, Valentina: *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: SHBLU, 2007, fq. 160.
 7. Fletorja Zyrtare nr. 97, Viti 1926, 15 qershor.
 8. Fletorja Zyrtare, nr.23, Viti 1929.
 9. Ligji u botua në Fletoren Zyrtare nr .46 , Viti 1938: Sipas tij: *I. Rrethi i Qendrës* përbëhej nga 10 komuna: 1. Komuna e Qendrës me qendër Elbasan, 2. Komuna e Çermenikës me qendër Zdrajsh, 3. Komuna e Dumresë (Belsh), 4. Komuna e Krrabës (Cacabezë), 5. Komuna e Librazhdit (Librazhd), 6. Komuna e Martaneshit (Martanesh), 7. Komuna e Quksit (Qukës), 8. Komuna e Shpatit të I-rë (Gjinar), 9. Komuna e Shpatit të II- të (Shtëpaj), 10. Komuna e Zaranikës (Branesh). *II. Rrethi i Nënprefekturës së Gramshit* përbëhej nga 4 komuna të cilat ishin: 1. Komuna e Qendrës me qendër Gramsh, 2. Komuna e Kukurit me qendër Kukur, 3. Komuna e Mollsit (Mollas), 4. Komuna e Tunjës (Tunjë). *III. Rrethi i Nënprekturës së Peqinit* përbëhej nga 4 komuna: 1. Komuna e Qendrës Peqin me qendër Peqin, 2. Komuna e Darsisë me qendër në Gjuzaj, 3. Komuna e Rrogozhinës (Rrogozhinë), 4. Komuna e Vrapit (Vrap).
 10. Jo pa qëllim pasqyruam të gjithë hartën e ndryshimeve dhe të organizimit të njësisve të qeverisjes vendore të krijuara nga viti 1912 -1944, për të krijuar një ide të qartë të emërtesave të fondeve arkivore dhe numrit të tyre, të cilët ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë.
 11. Gazeta Zyrtare, nr. 93, V,1946, D. 11.
 12. Rrethi Elbasan në përbërje të cilit ishin a. qyteti Elbasan me Elbasanin qendër dhe 4 lagje në gradë fshati, b. Lokaliteti i Shpatit me 12 fshatra, c. 64 fshatra;

- Rrethi i Gostimës kishte : a. 60 fshatra : Rrethi i Gramshit kishte : a. lokalitetin e Sojnikut me 11 fshatra, b. 56 fshatra: Rrethi i Librazhdit kishte: a. Lokalitetin e Qukësit me 19 fshatra, b. 27 fshatra”Rrethi i Peqinit kishte : a. 49 fshatra
- 13 Gazeta Zyrtare, V. 1958, fq. 42,43,44, 47, 48, 54.
 - 14 Lidheshin direkt me rrethin rreth 26 fshatra: 1. Fshati i Bashkuar Bradashesh, 2. Fshati i Bashkuar Galush, 3. Fshati i Bashkuar Gostimë, 4. Fshati i Bashkuar Grekan, 5. Fshati i Bashkuar Gjergjan, 6. Fshati i Bashkuar Gjocaj, 7. Fshati i Bashkuar Hajdaran, 8. Fshati i Bashkuar Kajan, 9. Fshati i Bashkuar Karinë, 10. Fshati i Bashkuar Kuqan, 11. Fshati i Bashkuar Klos, 12. Fshati i Bashkuar Kulej – Papër, 13. Fshati i Bashkuar Mollas, 14. Fshati i Bashkuar Pajovë, 15. Fshati i Bashkuar Pajun, 16. Fshati i Bashkuar Përparim, 17. Fshati i Bashkuar Shezë, 18. Fshati i Bashkuar Shtërmën, 19. Fshati i Bashkuar Topojan, 20. Fshati i Bashkuar Valas, 21. Fshati i Bashkuar Shalës, 22. Fshati i Bashkuar Kosovë, 23. Fshati i Bashkuar Belsh, 24. Fshati i Bashkuar Rrasë, 25. Fshati i Bashkuar Gradishtë, 26. Fshati i Bashkuar Seferan.
 - 15 Lidheshin direkt me rrethin: 1. Fshati i Bashkuar Bërsnik, 2. Fshati i Bashkuar Drizë, 3. Fshati i Bashkuar Gjergjovinë, 4. Fshati i Bashkuar Kodovjat, 5. Fshati i Bashkuar Koçaj, 6. Fshati i Bashkuar Mashan, 7. Fshati i Bashkuar Vinë. Fshatra që lidheshin direkt me rrethin ishin:1. Kishta, 2. Sotiri, 3. Tërvoli.
 - 16 Lidheshin direkt me rrethin: 1. Fshati i Bashkuar Dorëz. Fshatra që lidheshin direkt me rrethin ishin 1. Babje, 2. Librazhd – Katundi 3. Qarrishta.
 - 17 Arkiva Shtetërore Vendore (Më tej ASHV) Elbasan, F. 2, V. 1970, D. 443.
 - 18 Gazeta Zyrtare, V. 1992.
 - 19 Gazeta Zyrtare, Viti 2000.
 - 20 Gazeta Zyrtare, Viti 2014.
 - 21 Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave (Më tej DPA), *Manual arkivor, përktbime artikujsh nga literaturë e huaj*, Tiranë, 2008, fq. 29.
 - 22 Loli, Ivan: *Historia e Arkivave në Shqipëri*, Tiranë, 1999, fq. 9.
 - 23 Fletorja Zyrtare, Viti 1928, Nr. 74, Tiranë, 14 korrik 1928, Art. 5.
 - 24 DPA, *Manual Arkivor, përktbime artikujsh nga literaturë e huaj*, Tiranë, 2008, fq. 30.
 - 25 ASHV Elbasan, F. 2, V. 1970, D. 443.
 - 26 *Po aty*.
 - 27 *Po aty*.
 - 28 ASHVE, F. ASH i rrethit Elbasan, V. 1998, dosja e historikut të arkivit.

- 29 ASHVE, F. ASH i Rrethit Librazhd, V. 1999, D. Historiku.
- 30 ASHVE, F. ASH i Rrethit Gramsh, V. 1999, D. Historiku.
- 31 *Po aty.*
- 32 ASHVE, F. ASHVE, V. 2000, D. 6.
- 33 ASHRr Librazhd, V. 1999, D. Regjistër inventar i fondeve.
- 34 ASHVE, F. Dega arkivore Gramsh, V. 2003, D. 7.
- 35 Zaloshnja, Eduard: *Ruajtja e dokumenteve*, Tiranë, 2004, fq. 25.
- 36 ASHV Elbasan, F. 2, V. 1988, D. 19, fl. 3.
- 37 ASHV Elbasan, F. ASHV Elbasan, V. 1992, D. 1.
- 38 *Dispozita ligjore në RSH*, Tiranë, 2003, fq. 240.
- 39 ASHV Elbasan, F. ASHRr Gramsh, V. 1997, D. 1.
- 40 ASHVE. F. ASHVE, V. 2004, D. 2, fl. 2, 3.
- 41 ASHVE, F. ASHVE, V. 2007, D. 1.

BIBLIOGRAFI:

I. Fonde arkivore

- F. ASH Rrethi Gramsh, V. 1999, D. Historiku i arkivit.
- F. Ash Rrethit Elbasan, V. 1992, D. 1.
- F. ASH Rrethit Elbasan, V. 1998, D. Historiku i Arkivit.
- F. ASH Rrethit Librazhd, V. 1999, D. Historiku i arkivit.
- F. Dega arkivore Gramsh, V. 2003, D. 7.
- F. 2, V. 1946, D. 11.
- F. 2, V. 1953, D. 273.
- F. 2, V. 1970, D. 443.
- F. 2, V. 1988, D. 19.
- F. ASH Rrethit Gramsh, V. 1997, D. 1.
- F. ASH Rrethit Librazhd, V. 199, Regjistër inventar i fondeve.
- F. ASHV Elbasan, V. 2000, D. 6.
- F. ASHV Elbasan, V. 2004, D. 2, V. 2007, D. 1, V. 2015, D. 6.
- Regjistër inventar i fondeve

II. Dokumente arkivore të botuara

Fletorja Zyrtare nga V. 1922 – 1929, V. 1934 – 1940.

Gazeta Zyrtare nga V. 1946 – 2000.

Literatura historiografike, arkivore:

Bartl, Peter: *Myslimanët Shqiptarë në Lëvizjen për pavarësi Kombëtare (1878-1912)*, Tiranë: Shtëpia Botuese “Dituria”, 2006.

Duka, Valentina: *Histori e Shqipërisë, 1912-2000*, Tiranë, 2007.

Loli, Ivan: *Historia e Arkivave në Shqipëri (1912-1944)*, Tiranë, 1999.

Zaloshnja, Eduard: *Ruajtja e dokumenteve*, Tiranë, 2004.

Histori e Popullit Shqiptar, Vëll. III (Pavarësia e Shqipërisë 28 Nëntor 1912- 7 prill 1939), Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti I Historisë, Tiranë, Toena, 2007.

Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëll. I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti I Historisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2017.

Manual arkivor, përkthime artikujsh nga literatura e huaj, Tiranë, 2008.

Dispozita ligjore në RSH, Tiranë, 2003.